

VENDIM
Nr.1163, datë 13.8.2008

**PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SHKODËR, TË PRONËS SHTETËRORE, ME
NUMËR RENDOR 372 “BRIGADË KËMBËSORIE”, SHKODËR, DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË
SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 2, shkronja “c”, 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të bashkisë Shkodër, të pronës shtetërore, me numër rendor 372 “Brigadë këmbësorie”, Shkodër, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, për sigurimin e mjediseve shtesë, për veprimtarinë e institucioneve, në varësi të kësaj bashkie.

2. Heqjen e kësaj prone nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.

3. Bashkisë Shkodër i ndalohet t’ia ndryshojë destinacionin e përdorimit kësaj prone, si dhe ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Shkodër të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**3.FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE**

(Për inventarizimin e pronave si klasa të veçanta)

Bashkia Shkodër										
N r.	A		B				Funks ioni për të cilin përdo ret prona	C		
	Zon a kad ast. inde ksi i hart ës	Nr. i pasu risë	Emërtesa e pronës vendndodhja /shtrirja gjeografike	Kompo nentët përbërë s të pronës	Adresa/vend ndodhja e komponentë ve përbërës	Përm asat e pronës në m ² ose ml		Enti me përgjegj ësi administ rative	Enti përdor ues, statusi juridi k i përdor imit	Të dhën a të tjera , shën ime të veça nta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
372			Reparti ushtarak Nr.1100			3570 M2	Për mbrojt jen	MM Rep.Usht .8800 Tiranë	Rep.U sht Nr.110 0 Shkod ër	
			Shkodër	Komanda e shtabit	Shkodër	390				
				Policia ushtarake		20				
				truproja		20				
				palestra		200				
				oficina		600				
				truall		2340				